



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1015/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “EPE-SHOES” Sh.P.K., me numër unik identifikues dhe seli në Ferizaj, rr. P.nr., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit L.M, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “AVIA Center” Sh.P.K., me numër unik identifikues dhe seli në Fushë Kosovë,, duke vendosur sipas propjesimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 521/2021, i lejuar me datë 07.09.2021, nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 29.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT propjesimi i debitorit “AVIA Center” Sh.P.K., me numër unik identifikues, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 521/2021, i lejuar me datë 07.09.2021, nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, për pjesën e detyrimit në shumë prej EUR 4,536.40 (katër mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë Euro, e dyzet Cent), sipas Faturës Nr. 0031763, e datës 3.05.2020.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT propjesimi i debitorit “AVIA Center” Sh.P.K., me numër unik identifikues, për borxhin në lartësi prej EUR 2,812.40 (dy mijë e tetëqind e dymbëdhjetë Euro, e dyzet Cent) dhe në këtë pjesë Urdhri Përmbartimor P.nr. 521/2021, i lejuar me datë 07.09.2021, nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; faturës nr. 0031762, e datës 30.05.2020, faturës nr. 0031754, e datës 01.06.2020, faturës nr. 0031763, e datës 30.05.2020, faturës 0031764, e datës 30.05.2020, faturës 0031765, e datës 30.05.2020, si dhe faturës nr. 0031766, e datës 30.05.2020, ka lejuar urdhrin përmbartimor

P.nr. 521/2021, të datës 07.09.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 7,348.80, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e dorëzimit të këtij propozimi, datë 07.09.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për përbarim me arsyetim se urdhri është i pa bazuar në ligj, duke shtuar se nga kreditori ka kërkuar që një pjesë të mallit i cili nuk ka qenë në rregull ta bëj kthimin mbrapa dhe se, për një gjë të tillë, ka marr përgjigje nga kreditori i cili i ka thënë se do ta bëj kthimin e mallit, mirëpo që deri më sot nuk ka bërë kthimin e mallit i cili nuk ka qenë në rregull.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën ka theksuar se nuk ekzistojnë asnjëra nga kushtet për anulimin e urdhrin për përbarim, ngase i njëjti është konform dispozitave ligjore, ndërsa faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri për përbarim të mbetet në fuqi. Poashtu, i ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në lartësi prej EUR 208.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm ,sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr. 521/21, i datës 07.09.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori dhe atë në lartësi prej EUR 4,536.40, sipas Faturës Nr: 0031763, e datës 30.05.2020, ngase kjo faturë nuk i plotëson kushtet për të qenë dokumenti i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim. Kjo për arsye se, nga provat që gjenden në shkresa të lëndës, nuk mund të vërtetohet se fatura në fjalë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë me të cilën dëshmohet se e njëjta është dorëzuar në ndonjë mënyrë të rregullt tek debitori. Prandaj, fatura e lëshuar nga ana e kreditorit, mirëpo e papranuar nga debitorit, si e tillë, paraqet dokument të njëanshëm dhe nuk është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke e refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr. 521/21, të datës 07.09.2021, për shumën në vlerë prej EUR 2,812.40, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se për pjesën e lënë në fuqi urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturën nr. 0031762, e datës 30.05.2020, faturën nr. 0031754, e datës 01.06.2020, faturën nr. 0031764, e datës 30.05.2020, faturën nr. 0031765, e datës 30.05.2020, si dhe faturën nr. 0031766, e datës 30.05.2020, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në është treguar kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat, përkatësisht shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se faturat në fjalë janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit, ndërsa debitori të njëjtat i ka pranuar dhe i ka nënshkruar, rrjedhimisht është njoftuar për detyrimin që buron nga këto fatura.

Nga sa më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr. 1015/22, datë 29.05.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.